
	<p><b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p><b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 21, 22, 44 dhe 84 të Ligjit Nr. 05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 Nr. 350/02-89129/24 dt. 10.07.2024, dhe kërkesës 05 Nr. 350/02-89142/24 dt. 10.07.2024 të aplikuesit Ibrahim Maxhuni dhe Adelina Hasani Maxhuni, nga lagjja Arbëria 3, obj.B, nr.25, Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e dy shtëpive individuale banimore-shtëpive familjare, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 09.09.2024, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE**

**I. I caktohen kushtet ndërtimore** aplikuesit Ibrahim Maxhuni dhe Adelina Hasani Maxhuni nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-89129/24 dt. 10.07.2024, dhe 05 Nr. 350/02-89142/24 dt. 10.07.2024, dhe sipas kërkesës së palës për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e dy shtëpive individuale banimore-shtëpive familjare, me etazhitet P+1, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1276-13 dhe 1276-15, ZK. Çagllavicë.

**II. Lokacioni** i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 031-156871 dt. 27.08.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “Propozimit i bashkëngjitur i konstruksionit të zonës”. Për parametrat, kriteret urbane dhe kushtet e ndërtimit sipas PZHK-së, kërkuesi është informuar përmes "Informim nga Plani Zhvillimor Komunal-PZHK”, me referencë nr. 04-350/01-231950/23 dt. 13.12.2023, të lëshuar me dt. 22.12.2023, përmes Qendrës për shërbim me qytetarë, nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

**III. Gjendja ekzistuese** e lokacionit-parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

**Sipërfaqja e parcelave kadastrale: S= 689 m<sup>2</sup>**

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:  
nr.1276-13.....S=400, m<sup>2</sup>.... Ibrahim Maxhuni dhe Adelina Maxhuni Hasani.....”arë e klasës 3”
- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:  
nr.1276-15.....S=289, m<sup>2</sup>.... Ibrahim Maxhuni dhe Adelina Maxhuni Hasani.....”arë e klasës 3”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale në fjalë, bazuar në certifikatën e njësisë kadastrale dhe incizimin gjeodezik të prezantuar, nuk ka ndërtesa të ndërtuara;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni është relativisht i rrafshët
- Qasja e parcelës kadastrale është përmes rrugës ekzistuese “Ilirida”, dhe përmes rrugës me nr. parcelës kadastrale nr. 1970-0 ZK Çagllavicë, në pronësi të komunës, me gjendje faktike rrugë e kubëzuar dhe, sipas gjendjes kadastrale, me shfrytëzim aktual “infrastrukturë-rrugë”;

**IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin-ndërtimin e 2 (dy) shtëpive individuale banimore-shtëpisë familjare me etazhitet P+1, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:**

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Plani i lokacionit-“zgjidhja urbane”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Bazuar në manualin e bashkimit dhe ndarjes, parcelat kadastrale në trajtim, janë planifikuar të ndahen në tri njësi kadastrale-dy parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=320+303=623\text{m}^2$ , si dhe një parcelë kadastrale-parcela kadastrale-rrugë, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=66\text{m}^2$ .
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1276-13 dhe 1276-15 ZK Çagllavicë, planifikohet ndërtimi i dy ndërtesave individuale banimore/shtëpi familjare, në kuadër të parcelave ndërtimore (që do të formohen pas bashkimit dhe ndarjes së të njëjtave, sipas propozimit për ndarje), me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas llogarive dhe projekt propozimit, si në vijim:
  - **Shtëpia familjare “1”**, – shtëpi e veçantë, me etazhitet P+1, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimore  $S=205.10\text{m}^2$ , e shpërndarë nëpër etazhe: përdhesa me  $S=96.00\text{m}^2$ , dhe kati I-rë me  $S=109.10\text{m}^2$ , në kuadër të parcelës së re ndërtimore me  $S=320\text{m}^2$ , sipas propozimit për ndarje;
  - **Shtëpia familjare “2”**, – shtëpi e veçantë, me etazhitet P+1, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimore  $S=172.10\text{m}^2$ , e shpërndarë nëpër etazhe: përdhesa me  $S=90.10\text{m}^2$ , dhe kati I-rë me  $S=82.00\text{m}^2$ , në kuadër të parcelës së re ndërtimore me  $S=303\text{m}^2$ , sipas propozimit për ndarje;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore - brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës ose suterren, sipas PZHK-së, është max. 30 %, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:  
 $S=320 \times 0.3=96.00\text{m}^2$  / lejuar sipas PZHK-së, për Shtëpia familjare “1”/,  
 $S=303 \times 0.3=90.90\text{m}^2$  lejuar sipas PZHK-së, për Shtëpia familjare “2”/,  
 $S=96.00\text{m}^2$  / sipas projekt propozimit, për Shtëpia familjare “1”/,  
 $S=82.00\text{m}^2$  / sipas projekt propozimit, për Shtëpia familjare “2”/,
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës (ISHPN), për vendosjen e shtëpisë në bazë-gabarit të bodrumit është max. 60%, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, me kushtin që pjesa e nëntokës që shtrihet jashtë gabaritit, nuk mund të tejkalojë nivelin e truallit. Sipas projektit konceptual nuk është propozuar niveli i bodrumit për ndërtesat e planifikuara.
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISGJ), bazuar në planin rregullues dhe në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (40%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe kjo sipërfaqe është:  
 $S=320 \times 0.4=128.00\text{m}^2$  / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit, për Shtëpia familjare “1”/,  
 $S=303 \times 0.4=121.20\text{m}^2$  lejuar sipas Vendimit të Kryetarit, për Shtëpia familjare “2”/,  
 $S=128.00\text{m}^2$  / sipas projekt propozimit, për Shtëpia familjare “1”/,  
 $S=121.20\text{m}^2$  / sipas projekt propozimit, për Shtëpia familjare “2”/,
- Bazuar në kriteret e PZHK-së, koeficienti ndërtimor nuk është i përcaktuar, është përcaktuar vetëm etazhiteti maksimal, P+1, dhe ajo sipërfaqe ndërtimore do të llogaritet si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën  $\pm 0.00$ , 50% për etazhet me vëllim mbi 51% mbi tokë-suterren, dhe 0% për etazhet e nëntokës-bodrume;
- Bazuar në kriteret e PZHK-së, distanca në mes ndërtesave individuale për banim në fshatra është prej 5-10 metra, varësisht prej numrit të etazheve. Distanca e ndërtesës individuale për banim nga ndërtesat ekonomike (stallat, kotecet etj.) apo ndërtesat ndihmëse (fushore, depozitë e plehrave etj.) duhet të jetë minimum prej 25-30 metra;

- Distanca e vijës ndërtimore nga vija rregullative për objektet individuale për banim në fshatra, duhet të jetë 3-5 metra;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas PZHK-së, të jetë për “banim individual”, me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira të garazheve, etj. (sipas projektit konceptual të prezantuar);
- Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas PZHK-së, është P+1, poashtu, i propozuar dhe i miratuar është P+1;
- Elementet ndërtimore të ndërtesave (konzollat, strehët e hyrjeve me dhe pa shtylla, etj.) në nivel të katit mund të kalojnë vijën ndërtimore, duke llogaritur sipas gabaritit bazë të ndërtesës, gjegjësisht vijës ndërtimore, më së shumti 1.20 metra;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqë të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Qasja në parcelë të jetë kah rruga ekzistuese e lagjes;
- Për shtëpitë individuale të banimit, duhet të sigurohet 1 vendparkim, për një njësi banimi;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të eficiencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Të bëhet aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuara në kriteret dhe parametrat urban të PZHK-së, si dhe me normat dhe standardet tjera të planifikimit.

**V. Bashkimi dhe ndarja/** e parcelave kadastrale, nr. 1276-13 dhe 1276-15 ZK Çagllvicë, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore të përcaktuar me vijën rregulluese bazuar në Planin e situacionit - “zgjidhja urbane”, si dhe në manualin e bashkimit dhe ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar. Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - “zgjidhja urbane” dhe manuali i bashkimit dhe ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e bashkimit dhe ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për bashkimin dhe ndarjen në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në Planin e situacionit - “zgjidhja urbane” dhe manualin e bashkimit dhe ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VI. Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina”, bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga “Termokos”-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

**VII. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;

- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhese, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tredimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme

**VIII. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcela kadastrale nr. 1276-13 dhe nr. 1276-15 ZK Çagllavicë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "arë e klasës 3", dhe pasi që, për Planin Zhvillimor Komunal nuk është marrë pëlqim nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, për inicim të procedurës, kërkohet paraprakisht ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për parcelën e paraparë për ndërtim, konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që rregullojnë këtë fushë. Për pajisje me këtë pëlqim, me kërkesë duhet t'i drejtoheni kësaj drejtorie, me dokumentacionin e nevojshëm, e cila përmes aktit përcjellës, do të procedohet në kompetencë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Dokumentacioni i nevojshëm duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore, i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve).

**Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcela kadastrale nr. 1276-13 dhe 1276-15 ZK Çagllavicë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "arë e klasës 3", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit – "zgjdhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, me  $S=320+303=633 \text{ m}^2$ . Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

**IX. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën

për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, dhe “Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01nr.434/01-227572/23 dt.01.12.2023 obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit).

**X. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01-0094474/17 dt.24.04.2017 dhe “Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01nr.434/01-227572/23 dt.01.12.2023 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.**

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese, në kuadër të parcelave kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, sipas pikës 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënimin.

**XI. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimin për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.**

### **A r s y e t i m**

Aplikuesit Ibrahim Maxhuni dhe Adelina Hasani Maxhuni nga Prishtina me kërkesën 05 Nr. 350/02-89129/24 dt. 10.07.2024, dhe kërkesës 05 Nr. 350/02-89142/24 dt. 10.07.2024 kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e dy shtëpive individuale banimore-shtëpive familjare, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë aplikuesi ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 1276-13 dhe 1276-15, dhe certifikatën e njësisë kadastrale P-71914075-01276-13, dhe P-71914075-01276-15 ZK., Çagllavicë, lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- Kopjen të dokumentit të identifikimit të aplikueses si dhe personit të autorizuar;
- Informatën nga Plani Zhvillimor Komunal “PZHk”, e lëshuar më dt. 22.12.2023 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik- Prishtinë.
- Incizimi gjeodezik për parcelën kadastrale nr. 1276-13 dhe 1276-15 ZK Çagllavicë , i punuar nga gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, me nr. të licensës 09;
- Manualin për propozim për ndarje/këmbim të parcelave kadastrale me nr.1276-13 dhe 1276-15 të punuar nga kompania “Geo-Group” me nr. të licencës 52;

- Një kopje të dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor të shtëpisë individuale të banimit - shtëpisë familjare në kopje të fortë/fizike dhe kopje digjitale në CD, të hartuar nga kompania projektuese "VIA PROJECT" Sh.p.k nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810187402;

Drejtorja e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesave të ndara 05 Nr. 350/02-89129/24 dt. 10.07.2024 dhe 05 Nr. 350/02-89142/24 dt. 10.07.2024, për caktimin e kushteve ndërtimore hartimin e dokumentacionit ndërtimor-projektit ideor për ndërtimin e dy ndërtesave individuale banimore/shtëpi familjare, në parcelat kadastrale nr. 1276-13 dhe 1276-15 ZK Çagllavicë, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal-PZHK në Prishtinë, shqyrtimit të përmbajtjes së tyre dhe lokacionit, për të cilën kërkohet përcaktimi i kushteve ndërtimore, duke u mbështet në paragrafin 1. të nenit 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se, citojmë: "*Organi publik kompetent mund të bashkojë disa procedura administrative në një të vetme nëse të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë apo të ngjajshme*", vendosi të bashkojë dhe trajtojë në një procedurë të vetme administrative, gjegjësisht ti trajtojë me një vendim për caktim të kushteve ndërtimore, duke u bazuar edhe në faktin se parcelat kadastrale të lartcekura dhe të trajtuara, përfshihen në lokacion të njëjtë, Planit Zhvillimor Komunal-PZHK në Prishtinë.

Pas këtij konstatimi dhe veprimi administrativ, kjo drejtori mori në shqyrtim kërkesat e lartcekura, dokumentacionet e bashkëngjitura me kërkesa dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës administrative, konsultoi dokumentet e planifikimit hapësinor për lokacionin ku shtrihen parcelat - Planin Zhvillimor Komunal, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, projekt propozimin-projektin konceptual me "zgjidhja urbane" dhe projektin ideor, dhe procedurat e zhvilluara gjatë fazës së procedimit administrativ, në mënyrë procedurale dhe kronologjike, konstatoi se:

Parcelat kadastrale, nr. 1276-13, 1276-15, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=689 \text{ m}^2$ , përfshihen në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë, dhe sipas këtij plani, kjo zonë është e planifikuar me destinim "zonë për zgjerim të ndërtimit", i cili destinim është konfirmuar përmes shkresës "Informim nga Plani Zhvillimor Komunal-PZHK", me referencë 04-350/01-231950/23 dt. 13.12.2023, lëshuar nga Drejtorja e Planifikimit, dhe i cili njëherit është destinim i propozuar nga aplikuesit.

Pas pranimit të kërkesave dhe analizimit të Plani i situacionit - "zgjidhja urbane", duke u bazuar në nenin 18 të Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, pikën 1.2 dhe 1.2.2, të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, kjo drejtori me datë 19.07.2014, ka vendosur njoftimin publik në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej  $50 \text{ m}$ , për të njoftuar publikun me synimet e pronarëve dhe investitorit, dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre, për t'ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka vazhduar të qëndrojë deri me datën 23.07.2024, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë ankesë, kërkesë, vërejtje apo sugjerim nga qytetarët e asaj zonë.

Në fazën e periudhës së qëndrimit të njoftimit publik, është analizuar projekt propozimi i prezantuar, si koncept dokument, dhe është konstatuar se sipas të njëjtit, është planifikuar të ndërtohen dy ndërtesa individuale banimore/shtëpi familjare, në parcelat kadastrale nr. 1276-13 dhe 1276-15 ZK Çagllavicë, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal-PZHK në Prishtinë, me me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas përshkrimit në paragrafin IV, të këtij vendimi.

Bazuar në manualin e bashkimit dhe ndarjes, parcelat kadastrale në trajtim, janë planifikuar të ndahen në tri njësi kadastrale-dy parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=320+303=623 \text{ m}^2$ , si dhe një parcelë kadastrale-parcela kadastrale-rrugë, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=66 \text{ m}^2$ .

Aplikuesit, para aplikimit për leje ndërtimore duhet të përfundojnë procedurat për bashkimin dhe ndarjen e parcelave të trajtuara, bazuar në manualin për bashkim dhe ndarje të parcelave kadastrale, sipas përshkrimit në paragrafin V, të këtij akti, si dhe të bëjnë ndërrimin e llojit të shfrytëzimit të parcelave kadastrale, sipas përshkrimit në pikën VIII të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa, meqenëse parcelat kadastrale nr. 1276-13 dhe 1276-15, ZK Çagllavicë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara si kulturë "arë e klasës 3", "arë e klasës 3", dhe pasi që, për Planin Zhvillimor Komunal nuk është marrë pëlqim nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë

17 K 9 / 107

dhe Zhvillimit Rural, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, për inicim të procedurës, konform dispozitave ligjore të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që rregullojnë këtë fushë, obligohen pronarët dhe investitori, që paraprakisht aplikimit për leje ndërtimore, ta rregullojnë këtë çështje, duke ju drejtuar me kërkesë kësaj drejtorie, me dokumentacionin e nevojshëm, dhe e cila përmes aktit përcjellës, do të procedohet, në kompetencë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke bërë edhe pagesën e kompesimit për atë ndërrim të destinimit, konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që rregullojnë këtë fushë, sipas përshkrimit në pikën XIV të këtij akti.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, është konstatuar rregullsia e Planit të situacionit – “zgjidhja urbane” dhe janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të kompleksit me rrugën e brendshme të bllokut, me rrugën në e planifikuar të planit rregullues si dhe e njëjtat me rrugët tjera të planit ndër tjera konstatohet:

*“Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Ibrahim Maxhuni, dhe Adelina Hasani Maxhuni, në Çagllavicë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-89129/24 dt.10.07.2024, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese me nr. të parcelës 1970-0 Zk. Çagllavicë, për ndërtesën banimore me etazhitet P+1, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e till, marrë parasysh edhe gjendjen faktike të rrugës ekzistuese ne raport me parcelën kadastrale 01276-13, dhe 01276-15 Zk. Çagllavicë. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës ekzistuese, të respektohet profilimi i rrugës, dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes”.*

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe nenin 13 të “Udhëzim Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuessit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit- “zgjidhja urbane”, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i situacionit -"zgjidhja urbane" dhe Manuali i ndarjes të parcelave kadastrale, punuar nga kompania gjeodezike.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet:** Aplikuesit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr. 350/02-89129/24 dt. 10.07.2024 dhe 05 Nr.350/02-89142/24 dt. 10.07.2024.

**Kopja elektronike i dërgohet:** Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 350/02-89129/24 DHE 05NR.350/02-89142/24 DT. 09.09.2024**



Zyrtari,  
Shkurte Dalipi

Udhëheqëses së sektorit,  
Nazife Krasniqi









1276-1

Llogaritja e sipërfaqeve			
Përthjesa	Kat 1		96
Totali sipërfaqet e shtëpis			109.1
Sipërfaqja e parcelës			205.1
Sipërfaqja për shpërndarje			346.1
Sipërfaqja e parcelës pas shpërndarjes			261
Sipërfaqet që kalkulohen në Koficient			
Sipërfaqet që llogohen për shpërndarje në SHHP	Sipërfaqet që llogohen për ndërtim	Sipërfaqet që llogohen për shpërndarje në SHHP	Sipërfaqet e projektuar për shpërndarje në kat SHHP
320	320	320	320
30%	0.8	30%	34%
255	255	109.10	
Sipërfaqet e projektuar			142.90
320	45%		

www.viaproject-ks.com e-mail: info@viaproject-ks.com

**PROJECT**

**SHIPK PROJECT**

**Situacioni i Ngushtë**

**P.I.2.3**

06/08/2024

1:120

Prishtine Scale

Arch. Arjan Jusufi, Arch. Fortesa Gara, Arch. Urak Vanovci.

Ibrahim Maxhuni, Adelina Hasani Maxhuni, Shtëpi Banimi

623.00  
1675-0  
623.00

P+1

Llogaritja e sipërfaqeve			
Përfaqesia			90.1
Kat 1			82
Total sipërfaqet e shtesës			172.1
Sipërfaqja e parcelës			343.2
Sipërfaqja për shpirtëzim			40.1
Sipërfaqja e parcelës pas shpirtëzimit			103.1
Sipërfaqet që kalkulohen në koeficient			172.1
Sipërfaqet që lejohen për ndërtim	Sip. Parcelës	Koeficienti	Sip. e lejuara
	303.1	0.8	242.48
Sipërfaqet e Projektuara	303.1	0.568	172.1
Sipërfaqet e projektuar për shfrytëzimin e parcelës në kat ISHP	303.1	27%	82.00
Sipërfaqet e projektuar të qëlbëruese ISHGJ	303.1	45%	137.00

www.viaproject-ks.com e-mail: info@viaproject-ks.com

Projekues Design by: Erëmirra GËRGURI, Arch.MSc  
Lindon LLAPASHITCA, Arch

Investitor: Ibrahim Maxhuni  
Adelina Hasani Maxhuni

Objekt Objekt: Shtëpi Banimi

Paqartësimet Pajpë kontrolli

Projekti: P.R.1.2.3

Data dhe Vendi: Prishinë, Kosovë  
Date and Location: 06/08/2024

Faza: Përfunduar

Situacioni: Ngushtë

